

## **STATUT I**

### **SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " Taulantet 1 " SHPK**

#### **KREU I**

##### **EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI**

###### **Neni 1 – Emertimi dhe forma Ligjore e Shoqerise**

- 1.1 Emri I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte "Taulantet 1" Sh.p.k. (ne vijim "Shoqeria").
- 1.2 Shoqeria Taulantet 1 Sh.p.k. themelohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar dhe rregullohet prej ketij statuti dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 1.3 Emri i shoqerise mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.
- 1.4 Shoqeria ka vulen dhe logon e saj zyrtare.

###### **Neni 2 - Selia**

- 2.1 Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Njesia Bashkiake Nr.7, Blv.Gjergj Fishta, Pallati Nr.4, Ap. Nr.3.TIRANË
- 2.2 Asambleja e Pergjithshme mund te hapi, transferoje dhe/apo mbylle, si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj, dege dhe/ose zyra perfaqesimi. Ndersa, Administratori i Shoqerise mund te hapi, transferoje dhe/apo mbylle, si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj, seli sekondare dhe/ose filiale.

###### **Neni 3 – Kohezgjatja**

- 3.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore me afat te pacaktuar.
- 3.2 Shoqeria mund te priset ne cdo moment me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

###### **Neni 4 – Objekti i Shoqerise**

- 4.1 Veprimtaria financiare e kembimit valutor. Ushtrim i veprimtarise se transferimit te parave ne emer dhe per llogari te subjektit financiar jobanke "AK Invest Sha"

#### **KREU II**

##### **KAPITALI, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE TE SHOQERISE**

###### **Neni 5 – Kapitali I Shoqerise, kontributet dhe kuotat**

" Taulantet 1 " SHPK ("Shoqeria") eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, kapitali themeltar i shoqerise eshte 2,500,100 ( dy million e peseqind mije e njeqind) leke, i ndare ne 1 ( kuota) me vlere minimale 2,500,100 ( dy million e peseqind mije e njeqind) leke / kuote te cilat zoterohen nga ortaku i saj si ne vijim:

- i. Z. Kastriot Borri, shtetas shqiptar, lindur dhe banues ne Tirane, me 05.10.1957, me nr. personal F71005129S ortak zoterues I nje kuote qe perfaqeson 100% te kapitalit te shoqerise;

## Neni 6 – Zmadhimi dhe Zvogelimi I kapitalit te Shoqerise

6.1 Rritja e kapitalit mund te kryhet me vendim te Asamblese, kurdo dhe per me shume se nje here, permes kontributit ne para apo ne natyre apo me kredi, ne zbatim te dispozitave ligjore.

6.2 Rritja e kapitalit konsiderohet e kryher ne momentin kur kuotat e emetuara dhe te nenshkruara me pare jane shlyer teresisht.

6.3 Zvogelimi i kapitalit te Shoqerise mund te kryhet me vendim te Asamblese, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi. Ne cdo rast kapitali i Shoqerise nuk mund te zvogelohet nen minimumin e parashikuar me ligj.

6.4 Zvogelimi i kapitalit mbartet prej secilit ortak proporcionalisht me kuotat qe ai ka ne kapitalin e Shoqerise.

## Neni 7– Transferimi i kuotave te shoqerise

7.1 E drejta e pronesise mbi kuotat eshte lirisht e transferueshme tek te tretet ne perputhje me dispozitat e Ligjit nr.9901, date 14.03.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", I ndryshuar.

7.2 Ndalohet krijimi i te drejtave reale mbi kuotat e Shoqerise me qellim garantimin e detyrimeve te nje pale te trete, me ose pa pagese, pervecse kur me vendim te Asamblese se Pergjithshme parashikohet ndryshe

## KREU III

### ADMINISTRIMI

#### NENI 8 – Administrimi I Shoqerise

Organi me i larte vendimarrës i Shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve. Vendimet kryesore te veprimtarise se Shoqerise merren me vendim te Asambleja e Ortakeve, e cila ka te drejten te miratoje vendime ne lidhje me te gjitha ceshtjet e aktivitetit te saj.

Konkretisht Asambleja, ka kompetenca per te vendosur per ceshtjet e meposhtme:

- a. ndryshimin e Statutit;
- b. rritjen dhe zvogelimin e kapitalit te shoqerise;
- c. pranimin e ortakeve te rinj dhe transferimin e kuotave;
- d. bashkimin, ndarjen, transferimin, riorganizimin, shperberjen dhe cdo transferim tjeter te Shoqerise;
- e. blerjen, shitjen ose dhenien me qira te pasurive te paluajtshme te Shoqerise;
- f. emerimin dhe shkarkimin e Administratorit/eve,;
- g. miratimin e raporteve vjetore;
- h. miratimin e bilancit
- i. shperndarjen e fitimeve

j. kerkon dhenien e kredive, hipotekave dhe/ ose dhenia e garancive.

k. per te gjitha ceshtjet e tjera te cilat nuk parashikohen shprehimisht ne kete statut dhe qe I takojne ortakeve sipas ligjit per shoqerit tregetare.

Vendimet e Asamblese merren ne baze te kerkesave te kourumit dhe shumices perkatese te parashikuara nga ligji per shoqerist tregetare.

#### NENI 9 – Administratori/et

9.1 Administrimi i Shoqerise i caktohet nje administratori, per nje periudhe 5 ( pese) vjecare, me te drejte rizgjedhje. Ortaket kane te drejte te emerohet, apo shkarkojne ne cdo kohe administratorin.

9.2 Si Administrator I shoqerise emerohet:

Z. Kastriot Borri, shtetas shqiptar, lindur dhe banues ne Tirane, me 05.10.1957, me nr. personal F71005129S, shtetas Shqiptar, madhor e me zotesi te plote per te vepruar.

#### NENI 10 - Te drejtat e Administratorit/et

Administratori ushtron individualisht te drejtat e plota te caktuara per administrimin e Shoqerise dhe ka te drejten te miratoje vendimet qe gjykohen te drejta per arritjen dhe realizimin e objektit te Shoqerise, me perjashtimin e veprimeve qe me kete statut apo me ligj I jane rezervuar ortakeve.

Veprimet e meposhteme perfshihen ne aktet e administrimit te zakonshem:

- a. perfaqesimin e Shoqerise kundrejt paleve te treta dhe organeve publike;
- b. hapjen e llogarive bankare te Shoqerise prane Institucioneve bankare
- c. perfundimi i kontratave ose marreveshjeve me palet e treta;
- d. nenshkrimin e te gjitha dokumentave, leshimin e faturave, transferimet, pagesen e detyrimeve te Shoqerise;
- e. punesimi, shkarkimi, percaktimi i pagave dhe shperblimeve te tjera dhe cdo vendim tjetet lidhur me stafin e Shoqerise, ne perpudhje me udhezimet e miratuara nga Ortaket;
- f. mbajtja e librave kontabel, sic parashikohet nga ligji dhe parimet e kontabilitetit.
- g. pergatitja e pasqyrave financiare te Shoqerise dhe verifikimi i tyre nga auditore te jashtem, ne rast se kerkohet me ligj ose nga Ortaket;
- h. cdo veprim tjetet qe sipas ligjit per Shoqerite tregetare i takon administratorit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

Administratori, me prokure te posacme mund t'i delegeje paleve te treta permbushjen e akteve te vetme ose kategori te akteve.

### KREU IV

#### VITI FINANCIAR, PASQYRAT FINANCIARE VJETORE, NDARJA E FITIMIT

##### NENI 11 – Viti financiar dhe bilanci vjetor

11.1 Viti ushtrimor fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor.

11.2 Viti i pare ushtrimor fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit, dhe perfundon me 31 Dhjetor, te te njejtit vit.

11.3 Pasqyrat financiare dhe raporti i ecurise i hartuar prej Administratorit miratohen prej Asamblese se Pergjithshme.

11.4 Miratimi i dokumenteve lidhur me vitin ushtrimor duhet te kryhet brenda 6 (gjashte) muajve nga perfundimi i vitit financiar

#### **NENI 12 – Fitimet**

12.1 Fitimet neto qe rezultojne nga pasqyrat financiare vjetore, pasi jane zbritur te gjitha shumet qe Asambleja e Pergjithshme ka vendosur te vere menjane, i shpemdahen ortakeve te shoqerise

12.2 Asambleja, gjithashtu, mund te vendose te mbaje shuma te caktuara si rezerva, apo te shtyje shpemdardjen e fitimeve - teresisht apo pjeserisht — ne vitet ushtrimore pasardhes.

### **KREU V**

#### **SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE**

##### **NENI 13 – Shperndarja**

13.1 Shoqeria shperndahet ne perfundim te afatit te saj parashikuar ne statut apo edhe perpara ketij afati, ne rastet e parashikuar nga ligji apo me vendim te Asamblese se Pergjithshme, me shumicen e parashikuar per modifikimin e Statutit te Shoqerise.

##### **NENI 14 – Likuidimi**

14.1 Ne rast shperndarje Shoqeria do te kaloje ne likuidim

14.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja e Pergjithshme do te emeruje nje apo me shume likuidatore, te cilet do te paraqesin raportin perfundimtar mbi gjendjen e pasivit dhe aktivitet te Shoqerise, mbi veprimet e likuidimit dhe kohen e nevojshme per te perfunduar likuidimin.

14.3 Ne perfundim te procedures se likuidimit, Asambleja e Pergjithshme do te marre vendim ne lidhje me bilancin financiar perfundimtar, mbi vlefshmerine e punes se kryer prej likuidatorit dhe mbi perfundimin e procedures se likuidimit. Pas shlyerjes se kreditorëve, likuidatori shperndan te ardhurat perfundimtare te likuidimit tek ortaket, ne propocion me kuotat qe zoterojne.

### **KREU V**

#### **DISPOZITAT E FUNDIT**

##### **NENI 15 – Zgjidhja e mosmarrveshjeve**

15.1 Te gjitha mosmarrveshjet qe lindin nga ose ne lidhje me interpretimin ose zbatimin e ketyre dispozitave Statutore, midis ortakeve ose midis nje ose me shume ortakeve dhe Shoqerise, do te zgjidhen me marreveshje midis paleve te interesuara. Ne rast se nuk arrihet nje zgjidhje me marreveshje, palet do te mund t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

##### **NENI 16 – Dispozitat ligjore ne fuqi**

16.1 Per gjithcka qe nuk parashikohet ne kete Statut, zbatohen dispozitat ligjore ne fuqi.

NENI 17 – Gjuha

17.1 Ky statut hartohet ne 4 ( kater) kopje ne gjuhen shqipe.

Tirane, me 01 korrik 2023

ORTAKET E SHOQERISE

Z. KASTRIOT BORRI

Kastriot Borri

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Kastriot Borri', written below the printed name.